



Datë: 04.02.2026

Numër Protokolli: 613/2026

A.nr.1925/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurë sipas ankesës A.nr.1925/2025, të datës 20.11.2025, të parashtruar nga ankuesja R.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1925/2025, e datës 20.11.2025 e parashtruar nga ankuesja R.H.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, R.H, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 20.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli 7480/2025, kundër procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference: RN00018442 të datës 19.08.2025 të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.11.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të jashtme dhe Diasporës (tutje: MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 02.12.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 23.12.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:8045/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1925/2025 të datës 20.11.2025 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e datës 20.11.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 23.12.2025; Kopjen e ID-së së ankueses; Njoftimin e rezultateve të testit me shkrim të datës 20.10.2025; Njoftimin e datës 03.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; E-mailin e datës 20.11.2025 dërguar nga ankuesja për Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.11.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 02.12.2025; Testin me shkrim të ankueses; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Vërtetimin e datës 16.09.2025; Vërtetimin e datës 03.05.2023; Kopje e ID-së së ankueses; Letër reference e datës 10.10.2012; Letër reference e datës 24.07.2019; Vlerësim pune i datës 19.09.2019; Letër reference e datës 30.11.2017; Letër reference e datës 14.08.2014; Letër reference e datës 16.09.2025; Vërtetim i datës 19.08.2019; Shkresë e datës 13.09.2019; Marrëveshje e datës 09.11.2017; Marrëveshje e datës 01.06.2018; Vërtetim e datës 30.03.2018; Marrëveshje e datës 01.04.2018; Marrëveshje e datës 28.02.2019; Kontratë e punës e datës 15.11.2018; Kontratë e punës e datës 01.02.2019; Akt Emërimit e datës 27.05.2024; Vërtetimin e datës 16.09.2025; Vendimin e datës 28.06.2017; Diplomën e datës 22.08.2016; Vendimin e datës 28.06.2017; Diplomën e datës 03.08.2013; Aplikacionin e ankueses të datës 16.09.2025; Konkursin e datës 19.08.2025; E-mailin e datës 15.01.2025 dërguar nga H.B për Këshillin;

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është ***e pabazuar***, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Jashtme dhe diasporës me datë 19.08.2025 ka shpallur konkursin me shifër reference RN00018442, për Grupi i Shërbimit të Jashtëm, pozita e punës “Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm- Profesional 2”, 15 vende të lira të punës, ku afati për aplikim ka qenë nga data 20.08.2025 deri më 18.09.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 44 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja.

Tutje, ankuesja i është nënshtruar testimit me shkrim, ndërsa nga Njësia e Burimeve Njerëzore, është njoftuar se ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 35.4 pikë, të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuar nga Rregullore (QRK) Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë”, ndërsa ankuesja e pakënaqur me procedurën e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të datës 31.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Në ankesën e datës 20.11.2025 të parashtruar në Këshill, ankuesja pretendon se Njoftimi i datës 03.10.2025 me titullin “kandidatët që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë”, ka paraqitur konfuzion pasi që në fazën aktuale kandidatët ende nuk i ishin nënshtruar testit me shkrim, sikurse ankuesja po ashtu pretendon se vlerësimi i saj në testin me shkrim nuk ka qenë i saktë, me kërkesën që të njoftohet se si është bërë vlerësimi, sa pikë ka marrë eseja e saj, nga kush dhe sipas të cilave kriteret është vlerësuar e njëjta, me kërkesën për rishqyrtim ose anulim të konkursit.

Fillimisht Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin e saj ankimor për përmbajtjen e Njoftimit të datës 03.10.2025, konstatoi se Njoftimi në fjalë përmend emrat e 44 kandidatëve, ne mesin e të cilëve edhe ankuesja renditur në numrin 35, ndërsa sipas sqarimeve të dhëna nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së, përmes e-mailit të datës 15.01.2025, u be e ditur fakti se bëhet fjalë për lëshim teknik, si në vijim: “*Po ashtu ju theksojmë se gjate publikimit të Njoftimit për verifikim paraprak është lëshuar një gabim teknik, ne vend që të jete teksti “**kandidatët që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë**”, është dashur të jete “**kandidatët që kanë kaluar verifikimin paraprak**”, prandaj duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga LPPA, sipas nenit 50 të tij, Kolegji i Këshillit erdhi ë përfundimin se njoftimi në fjalë nuk ka cenuar të drejtën e kandidatëve në procedurë të rekrutimit të përcaktuar me ligjin material, pasi që bëhet fjalë për lëshim teknik në emërtimin e shkresës përkatëse, ndërsa kandidatëve të cilët e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak u është dhënë e drejta në testimin me shkrim, sikurse njësoj është vepruar edhe me ankuesen, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim me datë 16.10.2025.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga analizimi i testit me shkrim të ankueses konstatoi se e njëjta nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 35.4 pikë (prej të cilave 24 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 11.4 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil ku përcaktohet: “*Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit*” si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “*6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit*” dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlenë njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimit e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas formularit të testit të datës 16.10.2025 me shifër CN1918-ankuesja për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsejtë (11.4) pikë, sikurse përcaktohet

me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: “9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. **Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.**”, sikurse Kolegji i Këshillit konstatoi se eseja është parashtruar njësoj për të gjithë kandidatët si në vijim: “*Ndikimi i akterëve jo-shtetërorë në politikën e jashtme moderne*”, kurse ankuesja nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye e njëjta është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në esenë me shkrim, prandaj mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, pretendimet e ankueses nuk janë të bazuara dhe nuk gjejnë mbështetje në ligjin material.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër procedurës së rekrutimit me shifër reference RN00018442, për Grupi i Shërbimit të Jashtëm, pozita e punës “Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm”, ka të parashtruara edhe ankesa të tjera nga kandidatët në procedurë të rekrutimit, ankesa të cilat janë parashtruar kundër fazave të ndryshme të procedurës përkatëse, si dhe ankuesit/et në fjalë kanë pretendime të ndryshme nga ankuesja, prandaj vendimmarrja sipas kësaj lënde e identifikuar në Këshill nën shenjën A.nr.1925/2025 ka të bëjë vetëm me vendimmarrjen në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, të paraqitura si në ankesën e saj të datës 20.11.2025, si dhe të njëjtat janë pasqyruar edhe në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me objektin e shqyrtimit, gjegjësisht konkursin e kontestuar mund të veprojë vetëm pasi të ketë pranuar edhe aktet e tjera që zgjedhin ankesat përkatëse të parashtruara në Këshill, e për të cilat është njoftuar zyrtarisht.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ndërlidhur me nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1925/2025, datë 04/02/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, R.H;
- Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Diasporës (Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.